

1 Korrik, 2020

Te dashur anetare te komunitetit te UCS,

Gjate muajve te pranveresi gjithë komuniteti yne tregoi nje vigilance te madhe ne perballjen e sfidave ndaj pasojave te COVID-19. Stafi yne, dhe familjet e studenteve punuan se bashku per te siguruar qe studentet te vazhdonin nje edukim te perkryer, edhe pse shkollat ishin te mbyllura. Pavec kesaj, mesuesit, stafi, studentet dhe nje pjese vullnetarësh bashkepunuan per programin e shperndarjes ushqimore “Meet up and Eat Up” (Takohuni dhe hani se bashku).

Kjo fryme e perkushtimit per nje edukim te perkryer po vazhdon ndersa ne po presim me padurim qe studentet te rikthehen ne Utica Community Schools ne 1 Shtator, 2020. Skuadrat e punes te USC po punojne intensivisht ne disa drejtime, ne menyre qe studentet te jene te sigurte kur te perdorin transportin rrugor per tu kthyer ne shkollë, apo te jene pjese e mesimdhenies balle per balle, te kene ndoshta nje perzierje te disa modeleve te mesimdhenies, apo ndoshta te jene pjese e platformes se mesimdhenies on-line dhe gjithashtu te jene te sigurt ndersa nderveprojne me njeri tjetrin duke ruajtur distancen fizike. **Ne do te vazhdojme te sigurojme nje mesimdhenie te shkelqyer ndersa bejme te mundur sigurine dhe mirqenien e stafit dhe studenteve tane.**

Ne shtypin e djeshem “Harta e rruges se rikthimit ne shkollë” nga Shteti I Michiganit u perfshine udhezime, kerkesa dhe keshilla te cilat duhet te merren ne konsiderate gjate pandemise. Pjesa me e madhe e ketyre kerkesave jane te perfshira ne planet tona, dhe ne do te vazhdojme te perfshijme edhe ato kerkesa qe do te jene te nevojshme per vitin e ri shkollor.

Tre kerkesa qe kurre nuk do te ndryshojne ne Utica Community Schools jane:

1- Ne do te vazhdojme te krijojme nje ambient mesimor pozitiv, I cili bazohet ne nje mesimdhenie te shkelqyer dhe nje qasje te personalizuar.

2- Ne do te vazhdojme te bashkepunojme me familjet e studenteve ne menyre qe te plotesojme nevojat mendore dhe fizike te cdo femije qe regjistrohet ne Utica Community Schools.

3-Edhe nese femija juaj, eshte pjese e mesimdhenies balle per balle me mesuesin, mund te jete pjese e nje perzierjesh mesimdhenie apo do te jete pjese e platformes se mesimdhenien on-line, femijet tuaj do te kene gjithmone mbeshtetjen e sekretareve, mesueseve dhe anetareve te tjere te stafit ne menyre qe te kene nje vit mesimor te suksesshem por edhe nje shendet te mire mendor dhe fizik- ne ofrojme nje sere sherbimesh qe pjesa me e madhe e platformave on-line nuk mund ta ofrojne.

Ne jemi te vetdijshem, se rihapja e ketij viti shkollor, do te jete ndryshe nga vitet e tjera; megjithate, si distrikti shkollor I dyte me I madh I Miciganit, ne jemi te gezuar te mirepresim 27,000 student ne shkollat tona. Fillimi I vitit shkollor sjell shume energji pozitive, dhe femija juaj do te zbuloje deshiren per te mesuar dhe marrdhenien e vecante mesues- nxenes edhe pse ndodhemi ne mes te kesaj pandemie.

Nderkohe qe po mundohemi te perfundojme planet tona, une do te vazhdoj t'ju mbaj ne kontak me ndryshimet me te fundit. Sot, dua te ndaj me ju informacionin me te fundit persa I perket vitit shkollor 2020-2021:

- . Utica Community Schools eshte e pregatitur per te hapur vitin e ri shkollor 2020-2021 qofte me mesimdhenie balle per balle, nje perzierje mesimdhenie ndermjet te mesuarit nga shtepia dhe udhezimeve personale, apo nje mesimdhenie krejtesish on-line.

- . Ne e kuptojme se disa prinder kane femije me probleme shendetsore ose nje pjese e tyre nuk ndihen mire kur mendojne se femijet e tyre duhet ti kthehen mesimdhenies balle per balle. Ne pyetesorin e fundit ne komunitetin tone, shume nga prinderit shfaqen interes ne mesimdhenien e plote on-line edhe pse kerkesat per distance sociale vazhdojne. **Nese jeni te interesuar per te mesuar me shume rreth mesimdhenies on-line, kontaktoni sherbimet ndaj studenteve ne numrin e telefonit 586-797-1120.**

. Utica Community Schools do te beje te mundur shperndarjen e kompjuterave laptop per studentet ne vjeshte. Do tju japim me shume informacion per procesin e shperndarjes se tyre, ne baze te klasave, ndersa I afrohemi me shume fillimit te vitit te ri shkollor.

. Shkollat tona, duke perfshire edhe sherbimin ushqimore si edhe ate te transportit rrugor, do te mbeshtese shendetin dhe sigurine e komunitetit tone, duke ndjekur udhezimet e duhura per distance sociale, per higjenen e nevojshme, si dhe perdorimin e Paisjeve per Mbrojtje Personale (PMP).

. Gjate muajve te fundit, ne kemi pastruar shume mire te gjitha shkollat me dizinfektante te aprovuar dhe kemi perfshire protokolle shtese per pastrimin e tyre.

Hapja e shkollave sjell nje sezon te pafund mundesish per studentet dhe mbarvajtjen e tyre. Edhe viti shkollor 2020-2021 nuk perben asnje perjashtim, keshtu qe ne do te vazhdojme ti ofrojme keto mundesi perseri. Ne jemi shume te lumtur ti rihapim dyert e shkollave per studentet dhe stafin tone, due bere ate qe UCS di te beje me mire, te ofroje nje mesimdhenie dhe nje mesimnxenie te shkelqyer.

Sinqerisht,
Christine M. Johns, Ed.D
Superintendent of Schools